

VENDIM
Nr.630, datë 29.9.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.135, DATË 14.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË QENDRORE TË VLERËSIMIT TË
ARRITJEVE TË NXËNËSVE DHE PËR SHKRIRJEN E QENDRËS KOMBËTARE
ARSIMORE TË VLERËSIMIT DHE TË PROVIMEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 8 e vendimit nr.135, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“8. Struktura dhe niveli i pagave të nëpunësve në pozicionet “specialist” deri në “titullar i institucionit”, të Agjencisë Qendrore të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve caktohen në mbështetje të vendimit nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës.”.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha